



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	01.12.2025
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – NENTOR 2025

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.11.2025-31.11.2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit nëntor 2025-janë pranuar gjithsejtë 47¹-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura nga muaji paraprak kanë qenë 15 lëndë, në total 62 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 48 kërkesa, 19 të miratuara, 25 të refuzuara, pushim procedure 1 dhe 2 të pezulluara dhe 1 njoftim. Për shqyrtim në muajin vijues (dhjetor) barten 14 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në muajin nëntor janë pranuar dukshëm më pak kërkesa krahasuar me muajt paraprak të këtij viti. Nëse e krahasojmë me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, atëherë ku numër është pothuaj i njëjtë (49 kërkesa në nëntor 2024). Edhe për nga struktura, kërkesat pothuaj janë të njëjta. Dominojnë ato për kushte ndërtimi, leje ndërtimi dhe legalizim.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 10 konkluzione për pagesen e taksave. Prej tyre 3 konkluzione për leje ndërtimi, 2 për leje mjedisore komunale, 3 për shëndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimi dhe 2 për certifikatë legalizimi.

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj janë lëshuar 4 ftesa për kompletim të lëndëve. Brenda muajit nëntor pjesërisht është pranuar dokumentacioni përkatës për plotësimin e lëndëve.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Është hartuar Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2025.

Dy punonjës kanë marrë pjesë në takimin e organizuar nga MMPH, GIZ dhe AKK në temën “Plani 5 vjeçar për zhvillimin e kapaciteteve për planifikimin hapësinor në RKS”. Në kuadër të kësaj periudhe, pritët të ndryshohet Ligji për Planifikimin Hapësinor.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Drejtoratet relevante në procesin implementues të projekteve komunale.

Përpunimi i të dhënave për hartimin e Planit të punës për vitin 2026; dhe

Përpunimi i të dhënave për hartimin e Raportit të punës për vitin 2025.

¹ Janë pranuar edhe 3 kërkesa të tjera për plotësim dokumentacioni bazuar në kërkesat e parashtruara paraprakisht.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 1.

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim procedure -pezullim	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	9	1	1		7		2
2.	Leje ndërtimi	5	2	2		1		4
3.	Leje rrënimi	1	1		1 ²	1		
4.	Akte nga MMPHI- rish.		1	1				
5.	MMPH- p. procedure	1			1 ³			
6.	MMPH- K.Ndërtimi	1						
7.	Njoftim me Akt gjyq.	1			1 ⁴			
8.	QRTK-rekomandim	1		1				
9.	Informacione urbane	6		4		1		1
10.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	7	4	1		6		3
11.	Legalizimi/ Në listë të pritjes			1 ⁵				
12.	Bashkim/ndarje e parcelave	4	2	2	1 ⁶	2		2
13.	Kërkesë për LMK	2	2	2				2
14.	Qasje në dokumente	2		2				
15.	Pëlqim për panele solare	1				1		
16.	Ankesë – legalizim		1			1		
17.	Qasje në rrugë	1				1		
18.	Punime në rrjet energj.	1				1		
19.	Rehabilitim ujësjellësi	1				1		
20.	Kerkese për projekt	1				1		
21.	Qasje në arkivë	1				1		
22.	Detyrë projektuese	1		1				
23.	Kërkesë tjetër		1	1				
	Gjithsejtë:	47	15	19	4	25		14

² Nje kerkese për leje rrënimi është pezulluar përderisa nuk zgjidhet një çështje paraprake sipas nenit 85 të LPPA

³ Është Vendimi për pushimin e procedures për VNM – KRM Prishtina

⁴ Është akt i një pale me të cilin ka njoftuar se ka filluar proces gjyqësor për një çështje private

⁵ Lënda për legalizim e vendosur në Listë të pritjes është një prej gjithsejtë 10 kërkesave të pranuar dhe bartura per shqyrtim në muajin nëntor 2025.

⁶ Nje kerkese për bashkim parcele, e cila është pezulluar përderisa nuk zgjidhet një çështje paraprake sipas nenit 85 të LPPA

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 2.

Nr.	Kategoria e ndërtimit	Sipërf. Tokës – m2	Sip.nderësës- m2	Destinimi	Vendi
1.	II	6776	7711.3 B 866.61 A	NLB	Lipjan
2.	II	416	150 A	Afarist	Lipjan
Gjithsejtë		7192	8727.91		

Tokë e shfrytëzuar vetëm për afarizëm = 416 m2 me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 150 m2, kurse tokë e shfrytëzuar për banim dhe afarizëm në qytet 6776 m2 në të cilën janë ndërtuar 7711.3m2 për banim dhe 866.61m2 për afarizëm (NLB). Proporcioni i ndërtimit me destinim për banim është 87% kurse për afarizëm vetëm 13%

Në bazë të analizës së sipërfaqeve për ndërtim sipas destinimit del se gjatë muajit nëntor 2025 – rreth 93% e hapësirave të tokës ku është ndërtuar, ndërtesat janë destinuar për banim, kurse vetëm 7% e tyre janë destinuar për afarizëm. Ndërsa, proporcioni i ndërtimit me destinim për banim është 87% kurse për afarizëm vetëm 13%. Në përqindjen e afarizmit ka ndikim të theksuar pjesa afariste në kuadër të ndërtesës së lartë banimit dhe afarizëm, ku 866.61 m2 janë afariste dhe pjesa tjetër prej 7711.3 m2 janë për banim.

Ky fakt fletë se investimet direkte në fushen e ndërtimeve për qëllime të zhvillimit ekonomik janë tejet të vogla krahasuar me ato për qëllime banimi.

Buxheti:

Gjatë muajit nëntor 2025 të hyrat nga kategoritë e ndryshme nga fusha urbane janë relativisht të ulëta krahasuar me muajin paraprak. Në muajin tetor të hyrat e përgjithshme ishin 277,228.78 €, kurse në muajin nëntor të hyrat e përgjithshme ishin 58,760.35€.

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....43,320.83€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:1,869.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....13,295.36€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....275.16€
Te hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej00€

Shuma totale e të hyrave:58,760.35€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin nëntor 2025 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me shpenzimet kemi kryer obligimet ndaj operatorëve ekonomik. Nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime” mjetet e pashpenzuara janë simbolike. Megjithatë për shumën e zotuar për nevoja të Drejtoratit të Administratës, nuk kemi arritur të marrim të dhëna për nivelin e shpenzimeve.

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë nëntor tetor 2025 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

SFIDAT:

- Mosplotësimi i dy vendeve të lira të punës.